



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Deliverty	13.12.2021	viti god year	
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	6060/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.914/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtar, si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional cilësinë e procesmbajtëses duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.2074/2021 të datës 03.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me date 08.11.2021, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.566/2021 të datës 21.06.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në fshatin "Kryshefc" Komuna e Obiliqit kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.566/2021 e datës 21.06.2021 e parashtruar nga ankuesit
- II OBLIGOHET Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, që të ndërmarr veprimet e duhura procedurale të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, për realizimin e pagesës *shtesë për punën me ndërrime* për ankuesin, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- III Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesit dhe të punësuar në Komunën e Prishtinës në pozitën "Zyrtar për Emergjencë", në Qendrën e Thirrjeve në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe më datë 30.05.2019, 12.02.2020 dhe 12.05.2021 kanë parashtruar kërkesë tek Drejtoria e Administratës për kompensimin e shtesës mbi pagën bazë për punën me ndërrime gjatë natës, mirëpo në bazë të provave të lëndës ankuesit asnjëherë nuk kanë marr përgjigje në kërkesat e parashtruara.

Ankuesit të pakënaqur me mos përgjigjejen nga ana e Komunës së Prishtinës, me datë 21.06.2021 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 3198/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimet ankimore për kompensimin e shtesës mbi pagën bazë për punën me ndërrime gjatë natës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.06.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës ndërsa me datën 16.07.2021 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen nga Komuna e Prishtinës së bashku me shkresat e lëndës.

Më datë 30.06.2021 Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka shkarkuar anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Sekretaria e Këshillit më datë 04.08.2021 e ka njoftuar palën që Këshilli nuk ka vendosur për ankesën për shkak që është jofunksional, duke e udhëzuar që mund të inicioj procedurat tjera në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Në këtë rast ankuesi Adnan Tërrnava, ka iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 03.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2074/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e datës 04.08.2021 të Këshillit dhe duke e obliguar Këshillin të shqyrtoj ankesën e paditësit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.566/2021 të datës 21.06.2021 me numër të protokollit 31989/2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 16.06.2021; Akt Emërimit e datës 01.02.2017 me numër 112-909 të ankuesit Akt emërimit e datës 01.02.2017 me numër 112-618 të ankuesit Akt emërimit e datës 01.02.2017 me numër 112-65 të ankuesit Akt emërimit e datës 01.02.2017 me numër 112-163 të ankuesit Lista e punëtoreve lidhur me punën për ndërrime të natës; Formulari i datës 15.05.2021; Kërkesa e datës 30.05.2019 për pagesën e punës me ndërrime; Kërkesa e datës 12.02.2020; Plotësimin e ankesës me numër të protokollit 5626/2021 të parashtruar nga ankuesi me datën 24.11.2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 30.06.2021 me numër të protokollit 3377/2021; Përgjigja në ankesë e datës 16.07.2021 me numër të protokollit 3785/2021; Lista e pagave për muajt Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj dhe Qershor për ankuesin Lista e pagave për muajt Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj dhe Qershor për ankuesin Lista e pagave për muajt Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj dhe Qershor për ankuesin Lista e pagave për muajt Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj dhe Qershor për ankuesin Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën " Zyrtar për Emergjencja"; Emali i datës 16.11.2021 me numër të protokollit 5470/2021; Emalin e datës 16.11.2021 me numër të protokollit 54570/2021;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është pjesërisht e bazuar, sepse:



Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të Akt Emërimit te datës 01.02.2017, ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës "Zyrtar për Emergjencia", në Qendrën e Thirrjeve në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim,, në Komunën e Prishtinës.

Ankuesi më datë 30.05.2019, 12.02.2020 dhe 12.05.2021 ka parashtruar kërkesë në Komunën e Prishtinës, për njohjen e të drejtës për pagesën e shtesës mbi pagën bazë për punën me ndërrime gjatë natës, ndërsa në mungesë të përgjigjes nga Komuna e Prishtinës, ankuesi me datë 21.06.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se i takon e drejta në realizimin e shtesës në pagë për punën me ndërrime respektivisht gjatë ndërrimit të natës dhe atë nga data 10.04.2014 deri në parashtrimin e ankesës, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për njohjen e të drejtës për realizimin e shtesës në pagë për punën me ndërrime respektivisht për punën gjatë ndërrimit të natës, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke analizuar legjislacionin në fuqi, ka konstatuar se dispozitat e Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë përkatësisht në nenin 19 përcaktohet se „*Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*”, ndërsa në nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë janë përcaktuar tri kategori të shtesave mbi pagën bazë, ku paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 ka paraparë „*shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës*” po ashtu edhe në nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, janë paraparë „*shtesat për punën me ndërrime*”, kurse në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë është përcaktuar se, „*Zyrtari publik mund ...të punojë gjatë natës*”, andaj, si rrjedhojë Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se nëpunësve civile, sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, iu njihet e drejta e marrjes se pagesës shtesë mbi pagën bazë, për punën gjatë ndërrimit të natës dhe në këtë kuptim pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar, mirëpo duke u bazuar në paragrafin 1 të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se: „*Në institucionet e administratës publike, ku ekziston nevoja për punë me ndërrime sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin e Shërbimit Civil, nëpunësit civilë, të cilët punojnë në ndërrime jashtë orarit të rregullt të punës, kanë të drejtë të marrin shtesën për punë me ndërrime*”, Kolegji vlerëson se realizimi i shtesës në pagë për punë me ndërrime sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për ankuesin mund të bëhet vetëm pas aprovimit nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 15 paragrafi 2, ku përcaktohet se: ... *Institucionet e administratës publike, të cilat kanë nevojë për punë me ndërrime, duhet të kërkojnë miratimin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike mbi programin e punës me ndërrime, e cila autorizon shumën e shtesave për punën me ndërrime, që mund të paguhet nga institucionet e administratës publike*”, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se ... „*Institucioni, të cilit sipas specifikave dhe nevojave të punës i nevojitet puna me ndërrime, duhet të paraqesë kërkesë në ministrinë përgjegjëse për administratë publike për aprovimin e programit të punës me ndërrime. 2. Kërkesa e paraqitur, sipas paragrafit 1 të këtij neni përmban: 2.1. arsyeshmërinë e specifikave dhe nevojave për punën me ndërrime; 2.2. propozimin e orarit të punës me ndërrime; 2.3. pozitën për të cilat propozohet të punojnë me ndërrime jashtë orarit*

të zakonshëm të punës, duke përfshirë titujt, gradat dhe numrin e punonjësve për secilën pozitë dhe 2.4. koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për punë me ndërrime”.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit të bazës ligjore dhe konstatimit se me dispozitat e legjislacionit në fuqi nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin shtesën për punë me ndërrime dhe meqenëse ankuesit kanë ofruar dëshmi se kanë punuar në tri ndërrime duke përfshirë edhe ndërrimin e natës, vlerëson se Komuna e Prishtinës duhet të ndër marr veprimet e duhura procedurale për realizimin e shtesës në pagë për punën me ndërrime për ankuesin, siç parashihet me dispozitat e nenit 14 dhe 15 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe dispozitat e nenit 6 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, në këtë kuptim Kolegji ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin e shtesës për punë me ndërrime, në mënyrë retroaktive duke filluar nga data 10.04.2014, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 21.06.2021, andaj vlerëson se pretendimi ankimor për kompensimin e shtesës në mënyrë retroaktive është i pa bazuar për faktin se ankesa është parashtruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se; *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.914/2021

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Ilire Mehmeti-Shaqiri
Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK- së;